LIGJ
Nr.10 265, datë 15.4.2010

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË LETONISË PËR BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT, KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKIMIT TË PALIGJSHËM TË DROGAVE, SUBSTANCAVE PSIKOTROPE DHE PREKURSORËVE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Letonisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6523, datë 28.4.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË LETONISË MBI BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT, KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKIMIT TË PALIGJSHËM TË DROGAVE, SUBSTANCAVE PSIKOTROPE DHE PREKURSORËVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Letonisë (këtu referuar si "Palët"),

të udhëhequra nga përpjekjet për të kontribuar në forcimin e bashkëpunimit dypalësh,

të bindura në rëndësinë themelore të bashkëpunimit në luftën kundër krimit, veçanërisht terrorizmit, krimit të organizuar dhe trafikut të paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve,

duke pasur për qëllim rritjen e përpjekjeve të tyre të përbashkëta në luftën kundër terrorizmit,

duke dashur të harmonizojnë veprimet e tyre kundër krimit të organizuar ndërkombëtar;

duke marrë në konsideratë traktatet e rëndësishme ndërkombëtare,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

1. Duke marrë në konsideratë legjislacionet kombëtare të palëve dhe në zbatim të përmbajtjes së kësaj Marrëveshjeje, palët do të bashkëpunojnë në luftën kundër terrorizmit, krimit

të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve.

2. Palët do të bashkëpunojnë kryesisht në rastet ku krimet ose përgatitjet e tyre janë bërë në një nga territoret shtetërore të palëve, dhe informacionet e marra i referohen territorit të shtetit të palës tjetër.

Neni 2

Në luftën kundër terrorizmit, palët:

1. Do të shkëmbejnë informacione, mbi aktet terrroriste të kryera ose në planifikim e sipër, mbi pjesëmarrësit në këto akte kriminale, mbi metodat e kryerjes dhe pajisjet e përdorura.

2. Do të shkëmbejnë informacione, mbi grupet terroriste dhe pjesëtarët e këtyre grupeve, të cilat po përgatiten të kryejnë ose kanë kryer krime në një nga territoret shtetërore të palëve dhe që prekin interesat e palës tjetër, gjithashtu do të shkëmbehen informacione të cilat janë të nevojshme për të luftuar terrorizmin dhe krimet të cilat kërcënojnë seriozisht sigurinë publike.

3. Do të shkëmbejnë materiale analitike e të tjera që kanë lidhje me terrorizmin.

4. Do të shkëmbejnë eksperienca dhe njohuritë në fushën e garantimit të sigurisë.

5. Në përputhje me legjislacionet kombëtare të palëve, me kërkesën e njërës palë, pala tjetër ose të dyja palët së bashku do të kryejnë masa operacionale dhe të tjera.

Neni 3

Për të luftuar trafikun e paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve, palët:

1. Do të informojnë njëra-tjetrën, mbi personat të cilët janë të përfshirë në trafikimin e paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve, mbi vendet në të cilat fshihen, mjetet e transportit dhe metodat e kryerjes, mbi vendin e origjinës dhe destinacionin e drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve, si dhe çdo detaj tjetër të rëndësishëm që ka lidhje me këto krime, dhe që do të mund të ndihmojë në luftën kundër këtyre krimeve.

2. Do të informojnë njëra-tjetrën, mbi mënyrat e trafikimit të paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve, si dhe për fakte të tjera të rëndësishme.

3. Do të shkëmbejnë rezultatet e kërkimeve kriminalistike dhe kriminologjike mbi trafikun e paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve.

4. Do të vënë në dispozicion të njëra-tjetrës mostra të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve.

5. Do të shkëmbejnë eksperienca në kontrollimin e tregtisë legale të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve.

6. Në përputhje me legjislacionin kombëtar të palëve, me kërkesën e njërës prej palëve, do të kryejnë masa operacionale dhe të tjera.

Neni 4

Për të luftuar krimin, dhe kryesisht krimin e organizuar, palët:

1. Do të informojnë njëra-tjetrën, mbi personat e përfshirë në krimin e organizuar, lidhjet e tyre, strukturën e organizatave dhe grupeve kriminale, faktet e çështjeve (veçanërisht kohën, vendin dhe metodat e kryerjes), lehtësirat, masat e marra, dhe çdo detaj tjetër të rëndësishëm, që mund të jetë i nevojshëm për të luftuar krime të tilla.

2. Do të shkëmbejnë informacione për mënyrat e kryerjeve dhe format e reja të krimit të organizuar ndërkombëtar, si dhe për rastet e dyshuara për pastrim parash dhe financim terrorizmi.

3. Do të shkëmbejnë rezultatet e kërkimeve kriminalistike dhe kriminologjike eksperiencat mbi teknikat e hetimit dhe aplikimin e metodave të punës.

4. Në rast kërkese, do të vënë në dispozicion të njëra-tjetrës informacione, si dhe mostra

të objekteve, rezultat i akteve kriminale ose të përdorura për kryerjen e krimeve.

5. Do të shkëmbejnë ekspertë për trajnime të përbashkëta ose të ndërsjella, me qëllim rritjen e nivelit të ekspertizës dhe të studimit të arritjeve të reja në teknikat e investigimit, pajisjeve dhe metodave të përdorura në luftën kundër krimit.

6. Në përputhje me legjislacionin kombëtar të palëve, me kërkesë të njërës palë, pala tjetër, ose së bashku, do të kryejnë masa operacionale dhe të tjera.

Neni 5

1. Me qëllim implementimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të palëve, nga ana e Republikës së Shqipërisë:

Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

Dhe nga ana e Republikës së Letonisë:

Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit, Policia Kufitare, Shërbimi i Buxhetit të Shtetit, brenda kompetencave dhe fuqive të veta, do të bashkëpunojnë direkt me njëri-tjetrin.

2. Autoritetet kompetente të palëve mund të specifikojnë fushat definitive të bashkëpunimit dhe format e komunikimit në protokolle të veçanta.

3. Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën me anë të kanaleve diplomatike me kontakte informative të autoriteteve kompetente dhe brenda juridiksionit të kompetencave të tyre të nevojshme për komunikimin reciprok.

4. Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën në kanale diplomatike për ndryshimet në listën e autoriteteve kompetente të palëve të cilat janë referuar në pikën 1 të këtij neni.

5. Në mungesë të një marrëveshjeje tjetër, gjuha angleze do të përdoret në komunikimin dhe shkëmbimin e informacioneve ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve.

Neni 6

1. Bashkëpunimi midis autoriteteve kompetente të palëve do të vazhdojë në bazë të kërkesës. Kërkesa do t’u paraqitet autoriteteve kompetente të palës tjetër brenda kompetencave të tyre.

2. Kërkesat për bashkëpunim do të bëhen zyrtarisht me shkrim dhe do të dorëzohen me anë të çdo mjeti të sigurt teknik. Kërkesat për bashkëpunim do të nënshkruhen nga kreu i autoritetit kompetent ose zëvendësi i tij, ose persona të tjerë të autorizuar dhe certifikuar me vulën e autoritetit kompetent.

3. Kërkesat për bashkëpunim do të mbajnë emrin e autoritetit kompetent kërkues, objektin e kërkesës, justifikimin ashtu si dhe informacione shtesë mbi të dhënat personale. Kërkesat për bashkëpunim mund gjithashtu të shoqërohen me dokumente shtesë që kanë të bëjnë me subjektin e kërkesës.

4. Nëse autoriteti kompetent i njërës palë gjendet në pamundësi t’i përgjigjet ndonjë kërkese, ai do t’i kalojë kërkesën një tjetri autoritet kompetent, të së njëjtës palë, duke njoftuar në të njëjtën kohë autoritetin kompetent kërkues.

Neni 7

Duke marrë në konsideratë legjislacionet kombëtare të palëve për mbrojtjen e të dhënave personale, të dhëna të cilat do të transmetohen përgjatë bashkëpunimit do të aplikohen kushtet e mëposhtme:

1. Pala marrëse mund t’i përdorë të dhënat vetëm për qëllimet dhe sipas kushteve të caktuara nga pala transmetuese.

2. Me kërkesë të palës transmetuese, pala marrëse jep informacione mbi përdorimin e të dhënave të transmetuara dhe rezultatet e arritura.

3. Të dhënat personale mund të përdoren vetëm nga autoritetet kompetente të palëve, referuar në paragrafin 1 të nenit 5 të Marrëveshjes, në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve. Të dhënat mund t'i vihen në dispozicion një autoriteti tjetër vetëm më pas një leje paraprake me shkrim nga pala transmetuese.

4. Pala transmetuese merr përsipër të sigurojë që të dhënat e transmetuara të jenë korrekte dhe verifikon nëse transmetimi i të dhënave është i nevojshëm dhe korrespondon me qëllimin e menduar. Në rast se vërtetohet se të dhënat e dërguara rezultojnë jokorrekte ose të paautorizuara, pala marrëse duhet të informohet menjëherë. Pala marrëse korrekton gabimet ose, në rast se të dhënat nuk duhet të ishin transmetuar, i asgjëson.

5. Personit, të dhënat personale të të cilit janë dërguar, me kërkesë të tij dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar të palëve kontraktuese, duhet t'i jepet informacioni i nevojshëm mbi të dhënat dhe mbi synimin e përdorimit të tyre; në interes të sigurisë kombëtare dhe të rendit publik, këto informacione mund të refuzohen.

6. Në momentin e transmetimit të të dhënave, pala dërguese informon palën marrëse mbi afatin përfundimtar për asgjësimin e tyre, në përputhje me legjislacionin kombëtar të palës dërguese. Pavarësisht afatit të dhënat që lidhen me këtë person duhet të fshihen sapo të mos jenë më të nevojshme. Pala dërguese duhet të informohet mbi fshirjen e të dhënave të transmetuara, dhe mbi arsyet e fshirjes së tyre. Me përfundimin e kësaj Marrëveshjeje të gjitha të dhënat e marra si rrjedhojë e saj, duhet të asgjësohen.

7. Palët mbajnë regjistër të të dhënave të transmetuara, të dhënat e marra dhe të shuara në database, i cili të jetë i ndërtuar veçanërisht për këtë qëllim.

8. Palët mbrojnë në mënyrë efektive të dhënat personale të transmetuara, kundër akseseve të paautorizuara, ndryshimeve dhe publikimeve.

Neni 8

1. Palët mbrojnë fshehtësinë e informacionit të klasifikuar të tillë, në përputhje me legjislacionet kombëtare të palëve dhe kur kërkohet në bazë të legjislacionit kombëtar të palës dërguese.

2. Dokumentet, të dhënat dhe pajisjet teknike të transmetuara, si rrjedhojë e kësaj Marrëveshjeje, mund t'i kalojnë një shteti jopalë e kësaj Marrëveshjeje, vetëm pasi të jetë marrë leje me shkrim nga pala dërguese.

Neni 9

1. Me qëllim promovimin dhe forcimin e bashkëpunimit si rrjedhojë e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të palëve mund të ngrenë një komision të përbashkët. Palët njoftojnë njëra-tjerën mbi anëtarët e caktuar për komisionin e përbashkët me anë të kanaleve diplomatike.

2. Komisioni i përbashkët mban takime me iniciativë të secilës palë. Komisioni i përbashkët mban takime me radhë në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Letonisë.

Neni 10

Secila prej palëve mund ta refuzojë ose ta kushtëzojë, në tërësi ose pjesërisht, kërkesën për ndihmë ose për bashkëpunim, në rastet kur kryerja e saj kërcënon pavarësinë, rrezikon sigurinë, rendin publik, interesa të tjera baze ose dhunon legjislacionin e saj kombëtar.

Neni 11

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk cenojnë zbatimin e dispozitave të traktateve të tjera dypalëshe apo shumëpalëshe të lidhura nga Republika e Shqipërisë ose Republika e Letonisë.

Neni 12

Autoritetet kompetente të secilës palë mbartin shpenzimet e zakonshme të bëra prej tyre duke iu përshtatur kërkesës, por për pagesat e shpenzimeve të paparashikuara do të bihet dakord veçmas nga autoritetet kompetente të palëve në fjalë.

Neni 13

1. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me rrugën e negociatave direkte ose konsultimeve ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve brenda kompetencave të tyre.

2. Në rast se nuk bihet dakord me mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, referuar në pikën 1 të këtij neni, mosmarrëveshjet do të zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 14

Palët mund të bëjnë ndryshime dhe shtesa mbi këtë Marrëveshje në formën e protokolleve, të cilat bëhen pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje. Ndryshimet dhe shtesat e kësaj Marrëveshjeje hyjnë në fuqi në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 15 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 15

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar dhe hyn në fuqi në ditën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, ku palët njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme, të nevojshme për hyrjen në fuqi.

2. Secila palë mund ta përfundojë në çdo kohë këtë Marrëveshje, me anë të një kërkese me shkrim për këtë qëllim drejtuar palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Kjo Marrëveshje humb çdo lloj efekti pas 90 ditëve nga marrja e njoftimit.

Bërë në Tiranë, më 16 dhjetor 2009 në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe, letone dhe angleze, të gjitha tekstet të barasvlershme. Në rast se do të ketë keqkuptime në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë epërsi.